

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Boje fosforeshente, bikomponente, dylient”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

44811000-8

44832000-1

VLERA E FONDIT LIMIT:

8 950 000(tete milion e nentëqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa Tvsh

Bazuar në nenin 76 pika 3 të VKM 285 datë 19.05.2021 “Rregullat e Prokurimit Publik” e ndryshuar, në zbatim të urdhërit të titullarit, për ngritjen e komisionit për përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës për procedurën e prokurimit komisoni pasi u njoh me objektin e prokurimit, bazuar në VKM 285 datë 19.05.2021 neni 76, ka bërë përlllogaritjen e vlerës limit te kontrates.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoritet kontraktor Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Vlorë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapacitetin profesional te Operatoreve Ekonomike

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 (tre) vitet e fundit financiare 2022, 2023 , 2024, ku Vlera e xhiros minimale vjetore që kërkohet nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës.

Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2022, 2023, 2024.

Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar me VKM nr. 498, datë 1.8.2024.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”.

2.2.3 Vërtetim të shlyerjes së taksave e tarifave vendore për vitin 2025 në të gjitha pikat e ushtrimit te veprimtarise sipas të dhënave përkatëse të ekstraktit të QKB-së.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, në nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,ndryshuar me VKM nr. 498,datë 1.8.2024; në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2024 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për kontrata te mëparshme të ngjashme, ku vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a)** për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b)** për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ndryshuar me ligjin nr.16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 Për Prokurimin Publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin

e Rregullave të Prokurimit Publik”, ndryshuar me VKM nr. 498, datë 1.8.2024. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të madhe se 20 % të vlerës së fondit limit. Përvoja e mëparshme është një element i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

2.3.2 Autorizim nga prodhuesi/distributori i autorizuar për mallrat, objekt prokurimi. Në rast se paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar, duhet të vërtetohet lidhja ndërmjet distributorit të autorizuar dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbsite kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” me anë të këtij kriteri AK gjykon se autorizimi i prodhuesit ose distributorit të autorizuar është një dokument i rëndësishëm, pasi garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të mallit objekt prokurimi. Kjo garanci lidhet gjithashtu me treguesit e cilësive të mallrave e që janë prodhuar në përputhje me standardet. Ky kriter është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues mbi aftësitë teknike.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë për mallin objekt prokurimi katalogun dhe/ose skedat teknike të botuara nën autoritetin e prodhuesit, me logon e tij ku jepen të gjitha karakteristikat teknike të këtyre materialeve me qëllim që autoriteti kontraktor të verifikojë përmbushjen sipas specifikimeve teknike.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6, gërma b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, vendosja e këtij kriteri i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitetin e nevojshëm dhe të duhur për të ofruar mallin e kërkuar si dhe për të verifikuar përmbushjen sipas specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë në orën e përcaktuar për hapjen e ofertave, mostra të mallit, objekt prokurimi në amballazhim origjinal, nëpërmjet të cilave do të bëhet verifikimi i produktit.

Mosparaqitja e mostrave përbën shkak për skualifikim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar, në [Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”](#) dhe nenit 40, pika 6/a dhe 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar. Paraqitja e mostrave të kërkuara lidhet drejtpërdrejt me verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të produkteve të ofruara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me ato të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit.

Paraqitja e mostrave nga OE, është dhënia e mundësisë autoritetit kontraktor, i cili është përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, të kryejë verifikimet (ekzaminim, inspektim, testim) të mostrave të dorëzuara nga operatori ekonomik me qëllim vertetimin e përputhshmërisë me kërkesat e autoritetit kontraktor të pasqyruar në specifikimet teknike të procedurës së prokurimit.

2.3.5. Operatori ekonomik duhet të deklarojë se malli objekt prokurimi do të jetë i prodhuar jo më herët se 3 (tre) muaj nga data e lëvrimit të mallit pranë AK. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).

Argumentim: Në bazë të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar.

Vendosja e këtij kriteri, i shërben autoritetit kontraktor për t’u garantuar se boja do të ketë efektshmëri të lartë gjatë aplikimit me qëllim jetëgjatësinë e saj.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

SPECIFIKIME TEKNIKE

Karakteristikat e materialit për realizimin e vijëzimit

Materiallet

Lënda e parë që do të përdoret në vijëzimin e rrugëve duhet të jetë posaçërisht për të, të ketë sasinë e nevojshme të reflektivitetit dhe qëndrueshmëri. Të gjitha karakteristikat e mësipërme të jenë në përputhje me Standardin European ISO 9001; dhe UNE – EN 1436. Ofertuesi duhet të paraqesë deklaratën e origjinës së materialeve të përcaktuara në specifikimet teknike të mëposhtme, si dhe mostrat e materialeve që do të përdori.

Bojë plastike e ftohtë bikomponente e aplikueshme me sprucim, me karakteristika qëndrueshmërie në një kohe më të gjatë dhe për ngarkesa të mëdha dhe të dendura të trafikut dhe me një qëndrueshmëri 3 000 000 deri në 4 000 000 shkelje automjesh mbi material. Fusha e përdorimit do të jetë në vijat ndarëse të korsive, ndalimqendrimit, shkrimeve dhe shigjetave të drejtimit.

Karakteristikat Fiziko-Kimike:

Viskoziteti Brookfield, me metodë UNE 48076, me vlerë të deklaruar max. 105 KU.

Koha e Tharjes me vlerë < 30 min, me metodë UNE 135202.

Faktori i Ndriçimit me metodë UNE 48073-2, me tolerancë $\beta \geq 0,80$ dhe me vlerë 0,86, klas LF

Degradimin nga rrezet ultraviolet me metodë EN 1871 (UV-B) Varieteti $\beta\beta \leq 0,05$ x, y brenda zonës për ngjyrën e saj pa anomali sipërfaqësore apo defekte.

Densiteti Relativ me metodë EN-ISO 2811-1, me tolerancë $\pm 2\%$ e vlerës së deklaruar dhe me vlerë të deklaruar $\rho = 2.08 \{2.04 - 2.12\}$ Rezistenca ndaj alkaneve (aplikimi mbi beton) me metodë EN 1871.

Aplikimi: Boja përpara përdorimit duhet të përzihet mirë dhe kushtet atmosferike të jenë në një temperaturë mbi 5°C. Norma e harxhimit 1.4 – 2kg/m² (komponenti A+B+katalizator dhe më pas mikrosfera xhami). Koha e tharjes <30 min. Kontraktori duhet të dorëzojë një sasi prej 1 kg bojë për komponentin A, B dhe 1kg katalizator, nga të cilat do të përdorë sëbashku me specifikimet teknike të fabrikës dhe normat e konsumit dhe garancinë e jetëgjatësisë së vijës së shënuar. Ngjyra duhet të jetë ngjyrë e bardhë (ose e verdhë) puro. Ngjyra pas aplikimit duhet ti rezistojë kohës (e thatë, e lagësht dhe me shi).

Karakteristikat e Mikrosferave të Xhamit:

Indeksi thyes -- Klasi A

Maksimumi% e peshuar e rruazave -- Rruaza me diametër <1 mm -- Max.20% Rezistenca ndaj ujit, acid klorhidrik, klorur kalciumi dhe sulfide natriumi -- E kalueshme

Substanca të rrezikshme -- Class 1 për As, Pb dhe Sb

Mikrosferat e Xhamit duhet të kenë performance sipas standardit **EN 1423:2012 + AC:2013**

Bojërat e përdorura nuk duhet të absorbojnë graso, vajra, njolla të asnjë tipi dhe të ketë një përbërje kimike të përshtatshme që edhe në periudhën e mëpasme nuk duhet të ketë shenja të depërtimit të substancave bituminoze të shtresave asfaltike të rrugës. **Vijëzimi gjatë kohës së tharjes nuk duhet të shkelet nga automjetet.** Koeficienti i ashpërsisë (sipas R.R.R Anglez) nuk duhet të jetë më pak se 60% e sipërfaqes së pavijëzuar.

Kontraktori duhet të dorëzojë një sasi prej 1 kg bojë nga e cila do të përdorë sëbashku me specifikimet teknike të fabrikës dhe normat e konsumit dhe garancinë e jetëgjatësisë së vijës së shënuar. Ngjyra duhet të jetë e bardhë (ose e verdhë) puro. Ngjyra pas aplikimit duhet ti rezistojë kohës (e thatë, e lagësht dhe me shi).

Boje termoplastike me sprucim: Duhet përdorur pajisje që kanë njësi të llojit të dyfishtë të ngrohësit të ujit të kontrolluar termostatikisht duke shfrytëzuar transferimin e me nxehtësi të vajit apo kazanë ngrohës elektrikë të kontrolluara termostatikisht për të instaluar adhezivë bituminozë që aplikohen me nxehtësi.

Kontraktori do përdorë një lloj dhe projekt aplikuesi që është i mundur të japë në rrugë rezultatin e kerkuar për të bërë sa me uniform aplikimin e vijëzimit – si në tërmin e trashësisë së veshjes dhe vijëzimit në gjatësi. Gjithë makineritë do jenë sipas specifikimeve për qëllimin në fjalë. Njesia e udhëtimit do jetë e vlefshme që të shpërndajë uniform bojen me levizje të sakta, të paracaktoje shpejtësinë, për të prodhuar kështu një veshje uniforme. Makineria e bojes do jetë e llojit me spërkatje dhe do mundë të shpendajë boje në vlerën e kerkuar të spërkatjes pa holluar me këtë boje. Rezervuari i bojes do ketë një përzieres mekanik dhe the motorret do kenë valvula që do aplikojnë automatikisht linjat e shpërndarjes. Motorret do kenë një dispenser mekanik që do punojë vetë me një mjet spërkatës dhe do shpërndajë lenden sa me uniform që mundet për të arritur kështu vlerën e specifikuar. Secili motor do ketë drejtues të përshtatshëm linjash – si metalike edhe shkarkues ajri.

Sipërfaqja që do vijëzohet do pastrohet me anë të ngjeshjes apo ajrit të kompresuar apo menyrrave të tjera efektive, menjëherë përpara se të nisë procesi i aplikimit dhe të pastrohet tërësisht e të thahet sipërfaqja për tu shtruar.

Pesha specifike: 1.75 ± 0.10 kg /lt

Rrjedhshmeri: 85 ± 5 KU a 25 °C

Mbetje te thata: $99 \% \pm 1$

Rezistenca: Gerryerje = Perfekte / Vaji e Graso = E shkelqyer / Agjentet Atmosferike = E shkelqyer /Lende kunder ngrirjes.

Prodhim: 900 gr / m2 me nje trashesi /peshe rreth 600 micron.

Tharje: Koha e ngurtesimit dhe kalueshmerise varet nga temperatura e ambientit nga ajo e siperfaqes rrugore dhe nga trashesia e vijes.Ne 25 °C perthahet per 810 minuta dhe eshte e kalueshme per 12 - 15 minuta.

Katalizoj: Ngurtesimi ndodh mbi sprucimin mikrosfer ,rimbulon nje shtrese te holle benzine.Mbrojtje ne shtresen uniforme dhe vazhdimin mbi te gjithe vijen.Per gjysem ne nje spandiperline e pozicionuar mbrapa pistoletes qe aplikon vijezeimin.

Aplikimet: Siperfaqia do te duhet te jete e thate,ne mungese te pluhurit ,vajerat dhe lenda kunder ngrirjes.Perzierja mire e perberesit te teneqes perpara perdorimit.Per rikalimin e vijave te vjetra,per rifreskimin e rregullimit te sinjalistikes se vjeter.Duke perdorur makinen e skicimit te vijave posacerisht e pajisur me dopio spandiperline (Trafikndares akrilik me baze diluente). Boje rreshire me baze akrilike,per sinjalistiken horizontale rrugore me rruaza qelqi te tipit premixed.E specifikuar per raportimin si ne siperfaqet asfalt ne cemento,e mire per sinjalistiken urbane ,permendim boje alkid,akrilike,termoplastike. aplikuar 900 gr /m2 mbi sprucimin me mikrosfere te sforcuar 600 gr/ m2 me nje sistem injektimi.

Limiti per aplikacionet: Temperatura e ajrit : min 12 °C ,max 35 °C /Temperatura ne fund : min 12 ° C,max 45 ° C. /Lageshtira relative max 85 %. /Lageshtira ne fund max 3 %.

Materiali i magazinuar: 6 muaj ne kontenitoret origjinal te magazines ,hemertizimit te mbuleses dhe ne ambientin e fresket dhe thares ne nje temperature midis + 12 /+ 25°C.

Në të gjitha rastet kur nevojitet, kontraktori duhet të sigurojë heqjen e shenjave të vjetra (vijave), sikurse ç’ngjitjen dhe pastrimin e sipërfaqes nga elementë, të cilat dëmtojnë ose nuk kanë kapacitetin edhe kompabilitetin për të mbajtur materialin që do të aplikohet.

Argumentimi i specifikimeve teknike: Specifikimet teknike jane hartuar nga specialistët e fushës, pjesë e DST.

Specifikimet teknike, për procedurën objekt prokurimi, shprehin qartë kërkesat e autoritetit kontraktor për cilësinë e mallit dhe lidhen ngushtë me natyrën e kontratës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo specifikim dhe standard të kërkuar.**

NJESIA E PROKURIMIT

